

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2018**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2018

1.1. Operacione të tregut të hapur

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹)
Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1 javë <3 muaj	REPO Njëditore
05- 04-18		22.04		
12- 04-18		23.17		
19- 04-18		28.07		
23- 04-18				5.53
25- 04-18			21.06	
26- 04-18		22.73		
27- 04-18			23.98	
03- 05-18		18.95		
10- 05-18		14.98		
17- 05-18		16.48		
22- 05-18				8.18
23- 05-18				6.48
24- 05-18		21.88	19.43	
31- 05-18		20.18		
07- 06-18		19.60		
14- 06-18		12.35		
21- 06-18	1.78	20.18		
22- 06-18	1.24			
25- 06-18			12.10	
28- 06-18		16.49		

Në tremujorin e dytë të vitit 2018, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë (BSh) në tregun e parasë u realizuan nëpërmjet operacioneve në tregun e hapur për injektim likuiditeti. Në funksion të administrimit të mungesës së likuiditetit në sistemin bankar, si dhe të madhësisë së portofolit të titujve të Bankës së Shqipërisë janë kryer edhe veprime në tregun sekondar të titujve.

Gjatë tremujorit të dytë, injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit ka qenë rreth 40.19 miliardë lekë, shifër kjo e ngjashme me ato të dy tremujorëve paraardhës. Edhe këtë tremujor, shuma e injektuar është luhatur në një bandë të gjerë nga 28.99 mld lekë në fund të periudhës dhe 49.10 miliardë lekë në datën 25 prill 2018.

Faktori kryesor që ka ndikuar në rënien e mungesës së likuiditetit, në muajin qershor, ka qenë blerja e valutës nga BERZH-i, si dhe blerja nga tregu valutor me objektiv frenimin e forcimit të mëtejshëm të kursit të këmbimit. Likuiditeti i injektuar në tremujorin e dytë nëpërmjet blerjeve ka

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018


ndikuar në rritjen e likuiditetit në sistemin bankar në fund të periudhës për 28.21 miliardë lekë, ndërkohë që shuma e injektuar në tremujorin e mëparshëm ishte 2.53 miliardë lekë.

Faktor me ndikim në rritjen e mungesës së likuiditetit në sistemin bankar ka qenë akumulimi i likuiditetit në llogarinë e qeverisë për rreth 11.5 miliardë lekë, gjatë tremujorit. Njëkohësisht, një pjesë e sistemit bankar ka pasur tepriçë likuiditeti në mënyrë të qëndrueshme gjatë muajit qershor dhe e ka depozituar atë në Bankën e Shqipërisë në formën e depozitës.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjellë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 20.06 miliardë lekë ose 49.90% të totalit të injektimeve në sistemin bankar.

Operacioni rregullues për tërheqje njëditore është përdorur në 3 raste, për shumat 5.50-8.20 miliardë lekë në ditët e fundit të rezervës së detyrueshme të muajve prill dhe maj, ndërsa në 2 ditët e fundit të rezervës së detyrueshme të muajit qershor janë kryer operacione të injektimit njëditor të likuiditetit për shumat 1.78 dhe 1.24 miliardë lekë.

Grafik 1: Marrëveshje e anasjellë e riblerjes sipas maturimeve dhe viteve (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Operacionet për menaxhimin e portofolit të Bankës së Shqipërisë

Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka rritur portofolin e titujve për 2.45 miliardë lekë nëpërmjet veprimeve në tregun sekondar. Gjatë këtyre operacioneve janë blerë 2.85 miliardë lekë bono thesari 12-mujore dhe janë shitur 400 milionë lekë bono thesari 6-mujore në fund të muajit qershor.

1.3. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Bankat kanë përdorur depozitën në BSH në 2 raste, në dy muajt e parë të periudhës, për shumat 350 milionë lekë dhe 2.2 miliardë lekë, si dhe në mënyrë të vazhdueshme që prej datës 11 qershor për shuma në rënie nga 9.50 miliardë lekë në 5.88 miliardë lekë në fund të muajit qershor.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2018

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të datës 15.12.2017, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë në periudhën prill-qershor 2018 ka organizuar 3 ankande të blerjes së valutës, në përputhje me kalendarin e publikuar si më poshtë:

Kalendari i Ndërhyrjeve - Viti 2018		
	Data	Shuma Raundi I (në mln Euro)
1	22/02/2018	3-6 mln
2	23/03/2018	3-6 mln
3	20/04/2018	3-6 mln
4	17/05/2018	3-6 mln
5	22/06/2018	3-6 mln
6	26/07/2018	3-6 mln
7	24/08/2018	3-6 mln
8	16/10/2018	3-6 mln
9	15/11/2018	3-6 mln
10	14/12/2018	3-6 mln

Në tre ankandet e organizuara janë blerë 43.50 milionë euro, duke përdorur në të tre rastet opsionin e blerjeve në raundin e dytë, sikurse parashikohet në rregullore.

Rezultatet e detajuara të të gjitha ankandeve të zhvilluara nga Banka e Shqipërisë mund t'i gjeni në link-un:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

Në datën 5 qershor, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë me objektiv shmangien e çrregullimeve në tregun valutor, duke blerë *13.90 milionë euro* dhe më tej, prej datës 6 qershor janë blerë 51.40 milionë euro nga bankat e nivelit të dytë, me objektiv frenimin e forcimit të mëtejshëm të kursit të këmbimit. Nga totali prej 108.80 milionë euro të blera nga bankat e nivelit të dytë gjatë tremujorit, 71.50 milionë euro kanë qenë oferta për konvertimin e kapitalit të tyre.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Shuma e marrëveshjeve SWAP me Ministrinë e Financave ka rënë më tej gjatë 3-mujorit të dytë 2018 në 18.60 miliardë lekë, prej 25 miliardë lekësh në fund të muajit mars 2018 dhe 35.70 miliardë lekë në fund të vitit 2017. Gjatë muajit qershor, Banka e Shqipërisë ka blerë nga BERZH-i 116.22 milionë euro.

Blerje të tjera të zakonshme të valutës nga institucionet e huaja kanë qenë 351 mijë dollarë amerikanë të blera nga IBRD, 671 mijë euro nga Ministria e Financave (Fondet EPA) dhe i janë shitur ASD-së 43 mijë euro.